Ky informacion është i vlefshëm për OSSH-në që në fazën e Projekt Idesë paraprake, në mënyrë që të azhurnojë në kohë rrjetin elektrik ekzistues si dhe investimet e planifikuara. Shpresojmë në një bashkëpunim të vazhdueshëm në çdo etapë të implementimit të projekteve, për problemetikat që mund të dalin me rrjetin elektrik të OSSH-së.

Ky bashkëpunim do të sjellë përfitime të ndërsjellta duke eliminuar kostot shtesë në kryerjen e investimeve publike, duke shmangur ndërhyrje të panevojshme në infrastrukturë.

Me respekt,

ADMINISTRATOR I OSSH SH.A

Blendian DALIPI



OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A

DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 2366/2, Prot.

Tiranë, më 18.03.2025

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. Petrit AHMETI
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
Blv. Bajram Curri, Rr. Viktor Elftimiu, 1023 Tiranë

Për dijëni: "BALLKAN GREEN ENERGY" SH.P.K
Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Ap. 61, Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj, të regjistruar pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. me Nr. 2366 Prot. datë 04.03.2025, me lëndë "Në lidhje me problematikën e shoqërisë BALKAN GREEN ENERGY SH.P.K, në nënstacionin Fushënstacionin Fushë Aliaj – Hec Arras" ju informojmë si me poshtë.

Në zbatim të Ligji 43/20215 "Për sektorin e energjië elektrike", i ndryshuar, të Ligjit nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjië nga burimet e rinovueshme", në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjië elektrike, që nuk janë objekt koncesioni (ndryshuar me VKM nr.718 datë 12.10.2023, dhe VKM nr.633 datë 27.10.2021) si dhe Rregullores së Lidhjeve të Reja të miratuara nga ERE me vendim Nr. 166, date 10.10.2016 i ndryshuar, OSSH sh.a ka miratuar me Nr. 11056/3 Prot date 01.06.2022 ndryshim pikë lidhje të Hec" Borie Lura 1", me fuqi të instaluar P=1800 kW i shoqërisë "Ageta" sh.p.k.

Sa me sipër, Hec "Borie Lura 1" i jepet miratim për ndryshim pikë lidhje me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet çarjes së linjës 20 kV Hec Arras – N/Stacioni Fushë Aliaj me kusht që nëse lind nevoja investitori do të kryej investime për fuqizimin e linjës me qëllim mos të çënoj performancën e rrjetit, cilësin e furnizimit dhe prodhimit të subjekteve të tjera të lidhura në këtë linjë(Hec Arras).

Bashkëlidhur po ju përcjellim nje kopje të miratimit.

Faleminderit,

ADMINISTRATOR I OSSH SH.A

Blendian DALIPI



Nr. 3517/Prot.

Tiranë, më 08/4 2024

Lënda: **Përgjigje shkresës Prefekturës së Qarkut Vlorë**

Drejtuar: **Z. Vasian KONOMI**
Drejtor
Njësia Vlorë

Për Dijeni: **Z. Vangjel TAVO**
PREFEKTI I QARKUT VLORË

Vlorë

I nderuar,

Në përgjigje të shkresës me Nr 150/2 Prot, datë 18.03.2024, rregjistruar pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes Sh.a me Nr.3517 Prot, datë 29.03.2024, në lidhje me kërkesën e Prefektit të Qarkut Vlorë, me lëndë “Rikërkesë për informacion në lidhje me investimet e realizuara gjatë vitit 2023 dhe ato të planifikuara për vitin 2024”,
Ju bëjmë me dije si më poshtë:

Për vitin 2023, janë realizuar ose janë në proces zbatimi investimet e mëposhtme:

Bashkia Sarandë

- Zgjatim i fiderit OLM6, 20 kV , Nst Sarandë 110/20 kV, Berdenesh Nr. 5 - Ksamil Nr 13 (furnizimi i zonës Ksamil me linjë unazore) dhe zgjatimi i fiderit OLM 5 për furnizimin e zonës PSV (Marinë) Ksamil.
- Rikonstruksioni i kabinave ekzistues 20 kV dhe rrjetit TU 0.4kv, fideri OLM 5 (Ksamil), nënstationi Sarandë 110/20kV.

Bashkia Vlorë.

- Furnizimi i Aeroportit të Vlorës.
- Ndërtimi i Fiderave 20kV, L10 N.St. Vlora 1 dhe Fideri J10 N/St. Vlora 2, për furnizimin e objekteve në Portin e Vlorës.
- Ndërtimi i linjës kablllore 20kV, nënstationi Orikum - Tuneli Llogarasë
- Ndërtimi i linjës 20kV ajrore nënstationi Palasë - Tuneli Llogarasë

Bashkia Selenicë.

- Rikonstruksion rrjeti TM, kabina elektrike dhe rrjet TU me kabëll me vetëmbajtje të tipit ABC të fiderit Gorisht 5 dhe Amonic 4.

Për vitin 2024, janë planifikuar dhe miratuar investimet e mëposhtme:

Bashkia Himarë

- Zhvillim linjë TM (me izolacion 20kV) , kabina dhe linjë TU me percjellës ABC në Qeparo, nënstationi 35/10 kV.
- Zhvillimi i rrjetit TM, kabinave dhe rrjet TU me kabëll ABC në Borsh.

Bashkia Vlorë

- Zhvillimi i linjave TM 20kV, kabinave elektrike dhe linjat TU me percjellës ABC, për fiderat O1 dhe O2 nga nënstationi Orikum 110/35/20kV, për furnizimin me energji elektrike të zonës Radhimë.
- Ndërtimi i nënstationit të ri Akërnë 110/35/20kV dhe zhvillimi i linjës 35kV, nënstationi Akërnë- Aeroporti i Vlorës.

Bashkia Sarandë

- Ndërtim i nënstationit të ri Xarë 110/20/10kV.
- Ndërtim i nënstationit të ri Piqeras 110/20/10kV
- Zhvillimi i rrjetit kabllor TM 20kV OLM 5/1 , nënstationi Sarandë 110/20kV – Ksamil.
- Rikonstruksion rrjeti TM me izolacion 20kV, kabina dhe rrjet TU me ABC për fshatrat : Vrinë, Shendëlli, Xarrë, Mursi, Konispol, Vagalat, Livadhja dhe Finiq.
- Rikonstruksion i kabinave dhe linjat TU me kabëll ABC për fiderat OLM1 dhe OLM 2, nënstationi Sarandë 110/20 kV.

Bashkia Delvinë

- Zhvillimi i rrjetit TM, kabinave dhe rrjet TU me kabëll ABC në Delvinë .

Me konsideratë,

ADMINISTRATOR I OSSH SH.A

Blendian DALIPI

**OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT DHE RRJETIT TË TRANSMETIMIT**

Nr. 3930 Prot.

Tiranë, më 22.07.2025

Lënda: Mbi bashkëpunimin midis planeve zhvillimore midis 2 kompanive.

Z. Blendian Dalipi

ADMINISTRATOR I OSSH sh.a.

Blv. "Gjergj Fishta", Nd. Nr. 88, H. 1, Njësia
Administrative Nr. 7, 1023 Tiranë, Shqipëri

Për dijeni:

Z. Enea Karakaçi ✓

ADMINISTRATOR I OSHEE sh.a.

Blv. "Gjergj Fishta", Nd. Nr. 88, H. 1, Njësia
Administrative Nr. 7, 1023 Tiranë, Shqipëri

OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. Grup, më konkretisht me OSSH sh.a., janë në koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm për sa i përket harmonizimit të planeve zhvillimore mes tyre.

Nisur nga rëndësia që paraqet konsumatori, i cili është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes, OST sh.a. ka ndjekur në vijimësi të gjitha planet zhvillimore të OSSH sh.a. me qëllim sigurimin e furnizimit, nëpërmjet linjave të tensionit të lartë, të cilat më së shumti furnizojnë nënstacionet e reja të OSSH sh.a..

Në këtë kuadër, OST sh.a. vijon punën për të përmbushur në mënyrë sa më të plotë kërkesat e OSSH sh.a., duke i kushtuar vëmendje të veçantë koordinimit në aspektin kohor të zbatimit të projekteve të reja, në proces zhvillimi apo të parashikuara për nisje në periudhën e afërt. Në përputhje me kapacitetet dhe burimet në dispozicion, OST sh.a. angazhohet të maksimizojë eficiencën e veprimeve të saj, me qëllim përgjigjen e duhur dhe në kohë ndaj nevojave zhvillimore të OSSH sh.a.

Gjithashtu, konsiderohet e nevojshme që OSSH sh.a. të informojë në avancë OST sh.a., për planet e veta 5 (pesë) vjeçare, me qëllim që OST sh.a. ketë mundësinë të hartojë projeksionet e duhura burimore dhe organizative, si përgjigje ndaj kërkesave dhe zhvillimeve të planifikuara nga OSSH sh.a., në kohën e duhur.

Për objektet të cilat OST sh.a. ka në proces investimi, informojmë si më poshtë:

1. Ndërtim i Nënstacionit të ri Velipojë 110/35/20 kV

Për këtë objekt: “Instalimi i qarkut 110 kV në linjën egzistuese Bushat – Velipojë trakti përkatës në N/St. Bushat” ka një kontratë të lidhur me Nr. 3041/13 Prot. dt 31.10.2024 të cilës i është aprovuar projekt zbatimi dhe vijon puna me proceset e tjera të implementimit.

2. Fuqizimi i Nënstacionit 110/20 kV Zogu Zi (2x40) MVA

Për këtë objekt: “Ndërtimi i linjës kablllore 110 kV Tirana 1 – Zogu i Zi si dhe trakti përkatës në N/St. Tirana 1” ka një kontratë të lidhur me Nr. 3/1 Prot, dt. 10.01.2025 të cilës i është aprovuar projekt zbatimi dhe është në fazën e aplikimit për leje punimesh.

3. Ndërtim i Nënstacionit të ri Fier 2 110/20 kV

Për këtë investim është hartuar dhe dorëzuar detyra e projektimit, është në proces të përfundimit të ngritjes së grupit të punës për specifikimet teknike.

4. Ndërtim i Nënstacionit të ri Akërnj 110/35/20 kV dhe zhvillimi i linjës 35 kV Nënstacioni Akërnj- Aeroporti Vlorës.

Për këtë objekt: “Furnizimi i N/St. Akërnj 110/35/20 kV me tension 110 kV”, ka një kontratë të lidhur me Nr.4491/12 Prot, dt.24.12.2024 të cilës i është aprovuar projekti i zbatimit dhe vazhdon me procedurat e lejes së ndërtimit.

5. Ndërtim i Nënstacionit të ri Xarrë 110/20/10 kV

Për të mundësuar furnizimin me energji elektrike të këtij nënstacioni, pjesë e planit të investimeve 2025 ÷ 2027 të OST sh.a., është përfshirë edhe Projekti: “Ndërtimi i linjës 110 kV Sarandë – N/St. Xarrë me linjë me shtylla dopio qark dhe shtrirje të përcjellësit në një qark si dhe trakti përkatës i linjës 110 kV në N/St. Sarandë.

Është ngritur një grup pune për specifikimet teknike dhe është në proces hartimi ku së shpejti pritet përfundimi i tyre.

6. Ndërtim i Nënstacioni të ri Piqeras 110/20/10 kV

Për këtë objekt është lidhur kontrata: “Furnizimi i N/St. Piqeras 110/20/10 kV me tension 110 kV”. Kontraktori pritet të sjellë projektin e zbatimit si dhe për të vijuar më tej me zbatimin përkatësisht.

Faleminderit,

ADMINISTRATOR I OST sh.a.

Elisian Bici

Nr. 4252 Prot.

Tiranë, më 16/04/2024

Lënda : **Mbi Planifikimin e investimeve në nënstacionet e OSSH-së për vitin 2024.**

Drejtuar: **Z. Skerdi DRENOVA**
Administrator
OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SH.A

Për Dijeni: **Z. Enea KARAKAÇI**
Administrator
OSHEE GROUP SH.A

I nderuar,

Në zbatim të Ligjit Nr.43/2015, " Për Sektorin e Energjisë Elektike", i ndryshuar, Kodit të Shpërndarjes, Kapitulli II-"Planifikimi", ku specifikohen kriteret dhe procedurat që do të zbatohen nga OSSH Sh.a.për planifikimin dhe zhvillimin e Sistemit të Shpërndarjes, pika II.1 "Qëllimi", II.1.1, ku planifikimi i zhvillimit të Sistemit të Shpërndarjes ka qëllimet :

- i. Të hartojë planin e zhvillimit perspektiv të Sistemit të Shpërndarjes, për të qenë i aftë të shpërndajë energjinë elektrike në sasinë dhe cilësinë, e kërkuar prej Përdoruesve
- ii. Të përcaktojë operimin e Sistemit të Shpërndarjes sipas kushteve të sigurisë, si dhe të krijojë garancitë për të lejuar shpërndarjen e energjisë elektrike në nivelet e kërkuara të cilësisë.
- iii. Të orientojë dhe të nxisë investimet me efikasitet në Sistemin e Shpërndarjes, nëpërmjet inicimit të procedurave të nevojshme si dhe të mbledhë dhe përpunojë informacionin e nevojshëm për hartimin e planit të zhvillimit të sistemit

Ju informojmë se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.a ka përgatitur planin e investimeve për vitin 2024, për çdo Rajon, i cili konsiston në ndërtimet , fuqizimet e nënstacioneve dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes.

Më poshtë do të gjeni tabelën analitike të investimeve afat - shkurtër për ndërtimin dhe rikonstruksionin e nënstacioneve së bashku me koordinatat në sistemin UTM, ku do të ndërtohen këto nënstacione.

Nr	Emërtimi i objektit	Qyteti/ Komuna / Zona OSHEE	Nënstacioni	Niveli i tensionit (kV)	Fuqia e instaluar MVA	Shtesa e fuqisë MVA nga investimi		Vitet e planifikuara në planin e vitit 2024
						Afat shkurter	Totali	
1	Rikonstruksion dhe fuqizim i Nënstacioni Kafaraj 110/35/6 kV	Fier	Kafaraj	110/35/6 kV	10MVA 110/35/6kV + 5.6MVA 35/6kV	(2x40/50)MVA (110/35/6)kV	(2x40/50)MVA (110/35/6)kV	2024
2	Zhvillimi i linjës me dy qarqe 35kV(me izolacion 110 kV),nënstacionit Kafaraj Fier - Hoxharë (traseja e linjës ekzistuese 35kV)	Fier - Hoxhare		110kV				2024
3	"Ndërtimi i Nënstacionit të ri Akërnj 110/35/20kV dhe zhvillimi i linjës 35kV N/stac Akërnj- Aeroporti Vlorës"	Akërnj/Vlore	Akërnj	110/35/20kV		20MVA 110/35/20	20MVA 110/35/20	2024
4	Ndërtim i nënstacionit të ri Xarrë 110/20/10kV	Vlorë/Konispol/Xarrë	Xarrë	110/20/10kV		(2x20) MVA 110/20/10kV	(2x20) MVA 110/20/10kV	2024
5	Ndërtim i nënstacionit të ri Piqeras 110/20/10kV	Vlorë/Himarë/Piqers	Piqeras	110/20/10kV		20 MVA 110/20/10kV	20 MVA 110/20/10kV	2024

- Koordinatat e nënstacionit të ri Akërnj 110/35/20kV,

Nr	X	Y
1	369837.232	4495828.970

- Koordinatat e nënstacionit të ri Xarrë 110/20/10kV

Nr	X	Y
1	421806.38	4494396622.83

- Koordinatat e nënstacionit të ri Piqeras 110/20/10kV

Nr	X	Y
1	491862.76	4430600.79

Duke ju falenderuar për bashkëpunimi, jemi të gatshëm për çdo diskutim dhe koordinim të nevojshëm në lidhje me nënstacionet e sipërcituara.

Me respekt,

ADMINISTRATOR I OSSH SH.A

Blendian DALIPI



OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ASETEVE

Nr. 5727 Prot.

Tiranë, më 30/05/2025

Lënda: Mbi Planifikimin e investimeve në nënstacionet dhe linjat TL të OSSH-së për vitin 2025.

ELISIAN BICI
ADMINISTRATOR
OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
(Autostrada Tiranë -Durrës,Km9,Yrshek ,Kashar ,Tiranë)

Për dijëni: OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SH.A
(Bulevardi Gjergj Fishta, Ndërtesa Nr. 88,H. 1, 1023,Tiranë)

I nderuar,

Në zbatim të Ligjit Nr.43/2015, " Për Sektorin e Energjisë Elektike", i ndryshuar, Kodit të Shpërndarjes, Kapitulli II-"Planifikimi", ku specifikohen kriteret dhe procedurat që do të zbatohen nga OSSH Sh.a.për planifikimin dhe zhvillimin e Sistemit të Shpërndarjes, pika II.1 "Qëllimi", II.1.1, ku planifikimi i zhvillimit të Sistemit të Shpërndarjes ka qëllimet :

- i. Të hartojë planin e zhvillimit perspektiv të Sistemit të Shpërndarjes, për të qenë i aftë të shpërndajë energjinë elektrike në sasinë dhe cilesinë, e kërkuar prej Përdoruesve
- ii. Të përcaktojë operimin e Sistemit të Shpërndarjes sipas kushteve të sigurisë, si dhe të krijojë garancitë për të lejuar shpërndarjen e energjisë elektrike në nivelet e kërkuara të cilësisë.
- iii. Të orientojë dhe të nxisë investimet me efikasitet në Sistemin e Shpërndarjes, nëpërmjet inicimit të procedurave të nevojshme si dhe të mbledhë dhe përpunojë informacionin e nevojshëm për hartimin e planit të zhvillimit të sistemit.

Gjithashtu po në zbatim të Ligjit Nr.43/2015, " Për Sektorin e Energjisë Elektike", i ndryshuar,Neni 75,në pikën 3 thuhet:

" Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, gjatë hartimit të planit, merr në konsideratë zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe planifikimin urban dhe rajonal për zonën ku do të zhvillohet sistemi i Shpërndarjes".

Sa më sipër ju informojmë se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.a ka përgatitur planin e investimeve për vitin 2025, i cili konsiston në ndërtimet , fuqizimet e nënstacioneve dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes.

Plani i investimeve për vitin 2025, është miratuar në Këshillin Mbikqyrës me Vendimin Nr.1, datë 14.02.2025 dhe në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarit me Vendimin Nr.2047/1, datë 21.03.2025, "Mbi miratimin e programit Financiar të OSHEE Group SH.A të konsoliduar (OSSH,FSHU,FTL dhe OSHEE GROUP Individual) për vitin 2025.

Më poshtë do të gjeni tabelën analitike të investimeve afat - shkurtër për ndërtimin e nënstacionit dhe linjave TL

Nr.	Emërtimi i Investimit	Qyteti/ Komuna /Zona OSHEE	TOTALI (lek)
I	Ndërtim/rikonstrukcion elektrik për Nënstacionet		460,000,000
1	Ndërtimi i linjes re 35kV N.St Vukpalaj - Tamare, dhe N.Stacion i ri 35/10kV ne Tamare.	Shkodër	460,000,000
II	Ndërtim/Rikonstrukcion linjash të TL		1,147,300,000
1	Ndërtimi i linjës 35kV N.St Koplík 220kV - N.St Vukpalaj me dy qarqe..	Tiranë	310,000,000
2	Ndërtimi i linjës 35kV N.St 220kV Elbasan - Mjekës - Cerrujë - Gramsh.	DTL	600,000,000
3	Ndërtimi i Shtylles 110kV për lidhjen e nënstacionit të ri Kamëz 110/20kV me rrjetin 110 kV	DTL	7,300,000
4	Ndërtimi i linjës 35kV Kavajë - Rrogozhinë me një qark	DTL	230,000,000

Me konsideratë,

ADMINISTRATOR I OSSH SH.A

Blendi Dali





OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT

Nr. 2249/prot.
3

Tiranë, më 25.04.2024

Lënda: Miratim në parim i kërkesës për pikën e lidhjes së Nënstacionit Piqeras me rrjetin e transmetimit

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA
Blv.Gjergj Fishta, Ndërtesa Nr.88, H.1, Kati 5, Tiranë

Për dijeni:

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA
Blv.Gjergj Fishta, Ndërtesa Nr.88, H.1, Tiranë

Në vijim të komunikimeve dhe në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.4252 Prot., më datë 16.04.2024, me anë të së cilës parashtroni ndërtimin e N/Stacionit të ri 110/20/10 kV Piqeras dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit, me fuqi të instaluar të prozuar 2x20 MVA, Bashkia Himarë, dëshirojmë t'ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhja e N/Stacionit 110/20/10 kV Piqeras, me fuqi të instaluar 2x20 MVA, referuar kërkesës tuaj, me rrjetin 110 kV të transmetimit, do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një linjë 110 kV me dy qarqe me përcjellës ACSR 240/40 mm², me gjatësi rreth 0.5 km, nga N/Stacioni 110/20/10 kV Piqeras deri në çarjen e linjës 110 kV Himarë-Sarandë në pikën e përshtatshme. Traktet e linjës 110 kV dhe traktet e transformatorëve në N/Stacionin 110/20/10 kV Piqeras duhet të jenë të pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm primarë dhe sekundarë, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes dhe standartet e përdorura nga OST sh.a.

Projekti i plotë i zbatimit që përfshin çarjen e linjës elektrike ajrore 110 kV dhe N/Stacionin 110/20/10 kV Piqeras, duhet të miratohet nga OST SHA përpara fillimit të zbatimit të tij. OSSH SHA duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit të paisjeve dhe instalimeve elektrike në këtë investim. OST SHA do të jetë mbikqyrëse në të gjitha fazat e projekt-zbatimit të këtij investimi për pjesën që i përket daljeve të linjës 110 kV dhe impiantit 110 kV, deri në kolaudimin përfundimtar të tij.

OST do të ketë akses të plotë për të bërë në të ardhmen zgjerimin e N/Stacionit të ri 110/20/10 kV Piqeras me një dalje të re 110 kV, për nevoja të zhvillimit të sistemit të transmetimit sipas planvendosjes që ju keni përcjellë bashkëlidhur kësaj shkresë.

Të dhënat teknike të pajisjeve 110 kV që do të përdoren si dhe sistemi i kontrollit dhe mbrojtjes të transformatorëve ngritës 110/20/10 kV, duhet të jenë në konformitet të plotë

me publikimet më të fundit të standarteve IEC dhe EN. Specifikimet teknike të paisjeve 110 kV dhe atyre të kontrollit dhe mbrojtjes së elementeve të anës 110 kV të transformatorëve duhet të plotësojnë parametrat teknike kryesore sipas Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe miratuar nga OST.

Pika e matjes së energjisë elektrike për N/Stacionin e ri 110/20/10 kV Piqeras, me fuqi të instaluar 2x20 MVA (sipas Kodit të Matjes), do të jenë në daljet 110 kV të transformatorëve ngritës 110/20/10 kV me fuqi të instaluar 20 MVA, dhe duhet të plotësojnë standartin e kërkuar nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit/Kodi i Matjes.

Për qëllime të drejtimit të centralizuar të sistemit elektro-energjetik dhe veprimeve operative të nevojshme, transformimet 110/20/10 kV në N/Stacionin e ri, përveç lidhjes direkte të telekomunikacionit me N/Stacionet 110/35/20 kV Himarë dhe 110/20 kV Sarandë, duhet të futet në sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare Dispeçer. Të gjitha investimet që duhen për instalimin e paisjeve për këtë qëllim do të rakordohen me OST dhe duhet të përballohen nga OSSH SHA.

Përpara fillimit të punimeve për realizimin e kësaj lidhjeje, nga ana e shoqërisë aplikuese për lidhje me Rrjetin Kombëtar të Transmetimit, do të kryhet pagesa e Tarifave përkatëse sipas “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, miratuar me Vendim të ERE-s Nr.87, date 20.04.2018.

Pas nënshkrimit të “Marreveshjes së Lidhjes”, OSSH SHA fillon punën për realizimin e projektit të zbatimit, ku pjesa që i përket impiantit 110 kV dhe pikës së lidhjes në rrjetin e transmetimit, duhet të dërgohen në kompaninë OST sh.a. përpara fillimit të implementimit për të marrë aprovimin teknik.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

ADMINISTRATORI i OST SHA



Skerdi Drenova



**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT**

Nr. 2243/prot.

Tiranë, më 25 .04.2024

Lënda: Miratim në parim i kërkesës për pikën e lidhjes së Nëstacionit Akërnë me rrjetin e transmetimit

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA
Blv.Gjergj Fishta, Ndërtesa Nr.88, H.1, Kati 5, Tiranë**

Për dijëni:

**OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA
Blv.Gjergj Fishta, Ndërtesa Nr.88, H.1, Tiranë**

Në vijim të komunikimeve dhe në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.4252 Prot., më datë 16.04.2024, me anë të së cilës parashtroni ndërtimin e N/Stacionit të ri 110/35/20 kV Akërnë dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit, me fuqi të instaluar të prozuar 2x40/50 MVA, Bashkia Vlorë, dëshirojmë t'ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhja e N/Stacionit 110/35/20 kV Akërnë, me fuqi të instaluar 20 MVA, referuar kërkesës tuaj, me rrjetin 110 kV të transmetimit, do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një linjë 110 kV me dy qarqe me përcjellës ACSR 240/40 mm², me gjatësi rreth 1.4 km, nga N/Stacioni 110/35/20 kV Akërnë deri në çarjen e linjës 110 kV Vlora1-Kafaraj në pikën e përshtatshme. Traktet e linjës 110 kV dhe trakti i transformatorit në N/Stacionin 110/35/20 kV Akërnë duhet të jenë të pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm primarë dhe sekundarë, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes dhe standartet e përdorura nga OST sh.a.

Projekti i plotë i zbatimit që përfshin çarjen e linjës elektrike ajrore 110 kV dhe N/Stacionin 110/35/20 kV Akërnë, duhet të miratohet nga OST SHA përpara fillimit të zbatimit të tij. OSSH SHA duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit të paisjeve dhe instalimeve elektrike në këtë investim. OST SHA do të jetë mbikqyrëse në të gjitha fazat e projekt-zbatimit të këtij investimi për pjesën që i përket daljeve të linjës 110 kV dhe impiantit 110 kV, deri në kolaudimin përfundimtar të tij.

OST do të ketë akses të plotë për të bërë në të ardhmen zgjerimin e N/Stacionit të ri 110/35/20 kV Akërnë me një dalje të re 110 kV, për nevoja të zhvillimit të sistemit të transmetimit sipas planvendosjes që ju keni përcjellë bashkëlidhur kësaj shkrese.

Të dhënat teknike të paisjeve 110 kV që do të përdoren si dhe sistemi i kontrollit dhe mbrojtjes të transformatorëve ngritës 110/35/20 kV, duhet të jenë në konformitet të plotë

me publikimet më të fundit të standarteve IEC dhe EN. Specifikimet teknike të paisjeve 110 kV dhe atyre të kontrollit dhe mbrojtjes së elementeve të anës 110 kV të transformatorëve duhet të plotësojnë parametrat teknike kryesore sipas Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe miratuar nga OST.

Pika e matjes së energjisë elektrike për N/Stacionin e ri 110/35/20 kV Akërnë, me fuqi të instaluar 20 MVA (sipas Kodit të Matjes), do të jetë në daljen 110 kV të transformatorit ngritës 110/35/20 kV me fuqi të instaluar 20 MVA, dhe duhet të plotësojnë standartin e kërkuar nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit/Kodi i Matjes.

Për qëllime të drejtimit të centralizuar të sistemit elektro-energetik dhe veprimeve operative të nevojshme, transformimet 110/35/20 kV në N/Stacionin e ri, përveç lidhjes direkte të telekomunikacionit me N/Stacionet 110/20/6 kV Vlora1 dhe 110/35/6 kV Kafaraj, duhet të futet në sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare Dispeçer. Të gjitha investimet që duhen për instalimin e paisjeve për këtë qëllim do të rakordohen me OST dhe duhet të përballohen nga OSSH SHA.

Përpara fillimit të punimeve për realizimin e kësaj lidhjeje, nga ana e shoqërisë aplikuese për lidhje me Rrjetin Kombëtar të Transmetimit, do të kryhet pagesa e Tarifave përkatëse sipas “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, miratuar me Vendim të ERE-s Nr.87, date 20.04.2018.

Pas nënshkrimit të “Marreveshjes së Lidhjes”, OSSH SHA fillon punën për realizimin e projektit të zbatimit, ku pjesa që i përket impiantit 110 kV dhe pikës së lidhjes në rrjetin e transmetimit, duhet të dërgohen në kompaninë OST sh.a. përpara fillimit të implementimit për të marrë aprovimin teknik.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

ADMINISTRATORI i OST SHA



hob

OSHEE
OSHEE GROUP

OSHEE
GROUP

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS¹

Dërgues: OST

Nr. 2248/1, Prot. / Datë 25.04.2024

Marrës: ADMINISTRATORI I OSHEE GROUP SH.A.

Nr. 3568, Prot. / Datë 26.04.2024

Lënda: Miratim në parim i kërkesës për përcaktim të lloqes së Noust. Kuvë

Shënim i Titullarit: _____

E. Kote

Për t'u trajtuar nga: DEK/D. Liqi, Datë 26.04.2024

69

Afati: Normal (10 ditë) PRIORITETET (5 ditë) URGJENT!!! (brenda ditës)

OSSH SH.A. Nr. 1710, Prot. Datë 26.04.2024

FSHU SH.A. Nr. _____, Prot. Datë _____.2024

FTL SH.A. Nr. _____, Prot. Datë _____.2024

I ngarkuari: Pu OTC, Datë 28.04.2024

Shënim i eprorit: _____

Shënim i të ngarkuarit: _____

Dorëzuar porositesit më _____.2024

Shënime: _____

¹Ky format do të përdoret vetëm për shkresat që hyjnë në Protokollin e OSHEE GROUP SH.A., dhe që i takojnë për trajtim dhe zgjidhje shoqërive të kontrolluara, konkretisht, OSSH SH.A., FSHU SH.A. dhe FTL SH.A.



**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT**

Nr. 2249/prot.

Tiranë, më 25.04.2024

Lënda: Miratim në parim i kërkesës për pikën e lidhjes së Nënstacionit Xarrë (Mursi) me rrjetin e transmetimit

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA
Blv.Gjergj Fishta, Ndërtesa Nr.88, H.1, Kati 5, Tiranë**

Për dijëni:

**OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA
Blv.Gjergj Fishta, Ndërtesa Nr.88, H.1, Tiranë**

Në vijim të komunikimeve dhe në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.4252 Prot., më datë 16.04.2024, me anë të së cilës parashtroni ndërtimin e N/Stacionit të ri 110/20/10 kV Xarrë dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit, me fuqi të instaluar të prozuar 2x20 MVA, Bashkia Konispol, dëshirojmë t'ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhja e N/Stacionit 110/20/10 kV Xarrë, me fuqi të instaluar 2x20 MVA, referuar kërkesës tuaj, me rrjetin 110 kV të transmetimit, do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një linjë 110 kV me dy qarqe (njëri qark do të instalohet përcjellës) me përcjellës ACSR 240/40 mm², me gjatësi rreth 18 km, nga N/Stacioni 110/20/10 kV Xarrë deri në N/Stacionin 110/20 kV Sarandë për t'u lidhur në zbarrat 110 kV të këtij nënstationi. Traktet e linjës 110 kV dhe traktet e transformatorëve në N/Stacionin 110/20/10 kV Xarrë duhet të jenë të pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm primarë dhe sekondarë, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit/Kodin e Lidhjes dhe standartet e përdorura nga OST sh.a.

Projekti i plotë i zbatimit N/Stacioni 110/20/10 kV Xarrë, duhet të miratohet nga OST SHA përpara fillimit të zbatimit të tij. OSSH SHA duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit të paisjeve dhe instalimeve elektrike në këtë investim. OST SHA do të jetë mbikqyrëse në të gjitha fazat e projekt-zbatimit të këtij investimi për pjesën që i përket impiantit 110 kV, deri në kolaudimin përfundimtar të tij.

OST do të ketë akses të plotë për të bërë në të ardhmen zgjerimin e N/Stacionit të ri 110/20/10 kV Xarrë me një dalje të re 110 kV, për nevoja të zhvillimit të sistemit të transmetimit sipas planvendosjes që ju keni përcjellë bashkëlidhur kësaj shkrese.

Të dhënat teknike të pajisjeve 110 kV që do të përdoren si dhe sistemi i kontrollit dhe mbrojtjes të transformatorëve ngritës 110/20/10 kV, duhet të jenë në konformitet të plotë

me publikimet më të fundit të standarteve IEC dhe EN. Specifikimet teknike të paisjeve 110 kV dhe atyre të kontrollit dhe mbrojtjes së elementeve të anës 110 kV të transformatorëve duhet të plotësojnë parametrat teknike kryesore sipas Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe miratuar nga OST.

Pika e matjes së energjisë elektrike për N/Stacionin e ri 110/20/10 kV Xarrë, me fuqi të instaluar 2x20 MVA (sipas Kodit të Matjes), do të jenë në daljet 110 kV të transformatorëve ngritës 110/20/10 kV me fuqi të instaluar 20 MVA, dhe duhet të plotësojnë standartin e kërkuar nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit/Kodi i Matjes.

Për qëllime të drejtimit të centralizuar të sistemit elektro-energjetik dhe veprimeve operative të nevojshme, transformimet 110/20/10 kV në N/Stacionin e ri, përveç lidhjes direkte të telekomunikacionit me N/Stacionin 110/20 kV Sarandë, duhet të futet në sistemin SCADA të Qendrës Kombëtare Dispeçer. Të gjitha investimet që duhen për instalimin e paisjeve për këtë qëllim do të rakordohen me OST dhe duhet të përballohen nga OSSH SHA.

Përpara fillimit të punimeve për realizimin e kësaj lidhjeje, nga ana e shoqërisë aplikuese për lidhje me Rrjetin Kombëtar të Transmetimit, do të kryhet pagesa e Tarifave përkatëse sipas "Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit", miratuar me Vendim të ERE-s Nr.87, date 20.04.2018.

Pas nënshkrimit të "Marreveshjes së Lidhjes", OSSH SHA fillon punën për realizimin e projektit të zbatimit, ku pjesa që i përket impiantit 110 kV dhe pikës së lidhjes në rrjetin e transmetimit, duhet të dërgohen në kompaninë OST sh.a. përpara fillimit të implementimit për të marrë aprovimin teknik.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

ADMINISTRATORI i OST SHA



Skënder Drenova



OST
OPERATORI
I SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT

Nr. 2592 Prot.

Tiranë, më 3/3/2023

Lënda : **Mbi Planifikimin e investimeve në Nënstacionet e OSSH-së për periudhën 2023-2027.**

Drejtuar: **Z. Skerdi DRENOVA**
Administrator
Operatori i Sistemit të Transmetimit

I nderuar,

Në zbatim të Kodit të Shpërndarjes, OSSH sh.a përcakton dhe planifikon zhvillimin e Sistemit të Shpërndarjes në lidhje me si më poshtë:

- Hartimin dhe planifikimin e zhvillimit perspektiv të Sistemit të Shpërndarjes, për të qenë i aftë të shpërndajë energjinë elektrike në sasinë dhe cilësinë, e kërkuar prej Përdoruesve
- Përcaktimin e operimit të Sistemit të Shpërndarjes sipas kushteve të sigurisë, si dhe të krijojë garancitë për të lejuar shpërndarjen e energjisë elektrike në nivelet e kërkuara të cilësisë.
- Orientimin dhe nxitjen e investimeve me efikasitet në Sistemin e Shpërndarjes, nëpërmjet inicimit të procedurave të nevojshme si dhe të mbledhë dhe përpunojë informacionin e nevojshëm për hartimin e planit të zhvillimit të sistemit.

Në vijim të sa më sipër OSSH sh.a ka bërë parashikimin e planit të investimeve për periudhën 5 vjecare 2023 - 2027, për çdo Rajon, i cili konsiston në ndërtimet , fuqizimet e Nënstacioneve por dhe në drejtim të zgjerimit të rrjetit të shpërndarjes.

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë analitike janë paraqitur investimet afat - shkurtër dhe afat - mesëm për ndërtimin dhe rikonstruksionin e Nënstacioneve, të ndara në Investime me Fondet e OSSH sh.a dhe ato me financime të Huaja.

Nr	Emertimi i objektit	Qyteti/ Komuna /Zona OSHEE	Nënstacioni	Niveli i tensionit (kV)	Fuqia e instaluar MVA	Shtesa e fuqisë MVA nga investimi			Fuqia instaluar në n.stacion	Vitet e planifikuar a ne planin 5-vjeçar 2023.....
						Afat shkurtër	Afat mesëm	Totali		
1	Investime OSSH									
1	Fuqizimi i N.Stacionit 110/20kV Golem - Durrës	Durrës	Golem	110/20/6	31.5/15/25MVA	40/50MVA (110/20)kV		(31.5/15/25MVA)+(40/50MVA (110/20)kV)	(31.5/15/25MVA)+(40/50MVA (110/20)kV)	2023
2	Ndërtimi i Nstacionit të ri Velipoje 110/35/20kV	Shkoder	Velipoje	110/35/20kV	(20/25MVA 110/20)+(20/25MVA 110/35/20kV)	(20/25MVA 110/20)+(20/25MVA 110/35/20kV)		(20/25MVA 110/20)+(20/25MVA 110/35/20kV)	(20/25MVA 110/20)+(20/25MVA 110/35/20kV)	2023-2024

3	Fuqizimi i N.Stacionit 110/20kV Zogu Zi (12x0) MVA	Tirane	Zogu i Zi	05/2016	1x10MVA(35/20kV V) + 1x5.6MVA (35/6kV)	2(40/30)MVA 110/20kV		2(40/30)MVA 110/20kV	2(40/30)MVA 110/20kV	2023-2024
4	Ndërtim i N/Stacionit të ri Fier 2 110/20kV	Fier	Fier 2	110/20		(2x40/30) MVA (110/20 kV)		2x40/30 MVA (110/20 kV)	2x40/30 MVA (110/20 kV)	2023-2024
5	Rikonstruksion dhe fuqizimi i N.Stacionit KUCOVË 110/35/20/10/6kV	Berat	Kucovë	110/35/10/6kV	20MVA 35/6kV + 2(7.5MVA 35/6kV) + (7.5MVA 110/35/6kV)	2(31.5MVA 110/35/20kV) + 2(31.5MVA 110/10/6kV)		2(31.5MVA 110/35/20kV) + 2(31.5MVA 110/10/6kV)	2(31.5MVA 110/35/20kV) + 2(31.5MVA 110/10/6kV)	2023-2024
6	Rikonstruksion i N.Stacionit Pogradec 110/35/10kV ne 110/35/10/20kV	Pogradec	Pogradec	110/35/10kV	(1x10)MVA 110/10kV+(1x10)MVA 110/35/10kV	(1x20/25)MVA 110/20/10kV+(1x20/25)MVA 110/35/10kV		(1x20/25)MVA 110/20/10kV+(1x20/25)MVA 110/35/10kV	(1x20/25)MVA 110/20/10kV+(1x20/25)MVA 110/35/10kV	2023-2024
7	Rikonstruksion dhe fuqizimi i N.Stacionit Corovode e Re 110/35/10kV	Corovode	Corovode e Re	110/10kV	31.5MVA 110/10kV	31.5MVA 110/35/10kV		31.5MVA 110/10kV+31.5MVA 110/35/10kV	31.5MVA 110/10kV+31.5MVA 110/35/10kV	2023-2024
8	Rikonstruksion i N.Stacionit Lezhe nga 110/10kV ne 110/20/10kV	Lezhe	Lezhe	110/10	(1x40 + 1x20)MVA 110/10kV	1x40/30 MVA(110/20kV)		1x40/30 MVA(110/20kV)	(1x40 + 1x20)MVA 110/10kV+(1x40/30)MVA 110/20kV	2023-2024
9	Fuqizimi i N.Stacionit 35/6kV Pallati Kongresive transformatorat 35/20kV (2x15)MVA	Tirane	Pallati Kongresive	35/6	(2x5.6)MVA		(2x15)MVA 35/20kV	(2x15)MVA 35/20kV	(2x5.6)MVA+(2x15)MVA 35/20kV	2025-2027
10	Rikonstruksion i N.Stacionit Hec Lanabregas 35/10kV dhe fuqizimi me transformatore 35/20kV (1x15)MVA	Tirane	Hec Lanabregas	35/6kV	(1x5.6)MVA		(1x15)MVA 35/20kV	(1x15)MVA 35/20kV	(1x15)MVA 35/20kV	2025-2027
11	Ndërtim i N.Stacionit Fushë Krujë 110/20kV (Zevendesimi i n/st. Mobile) Transformatore ONAN/ONAF 40/30MVA	Fushë Krujë	Fushë Krujë Mobile	110/20	(1x25/30)MVA		(1x40/30)MVA 110/20kV	(1x40/30)MVA 110/20kV	(1x40/30)MVA 110/20kV	2025-2027
12	Fuqizimi i N.Stacionit Shkodra I me transformatore Tr.2 (110/20kV (1x40)MVA	Shkoder	Shkoder 1	110/35/20/6kV	(1x40)MVA 110/6kV + (1x25)MVA 110/20kV		(1x40/30) MVA(110/20kV)	(1x40)MVA 110/6kV + (1x25)MVA 110/20kV+(1x40/30) MVA(110/20kV)	(1x40)MVA 110/6kV + (1x25)MVA 110/20kV+(1x40/30) MVA(110/20kV)	2026
13	Ndërtim i N.stacioni Lozhan 110/35/10kV 25MVA	Korce	Lozhan	35/10	(1x1.8)MVA 35/10kV		(1x25)MVA (110/35/10 kV)	1x25 (110/35/10 kV)	1x25 (110/35/10 kV)	2025-2027
14	Rikonstruksion N.Stacioni 35/10kV Grapsh ne 110/20/10kV , Tr. ONAN/ONAF (1x20/25)MVA	Gjrokaster	Grapsh	35/10	(2x3.2)MVA 35/10kV		(1x20/25)MVA (110/20/10 kV)	(1x20/25)MVA (110/20/10 kV)	(1x20/25)MVA (110/20/10 kV)	2025-2027
15	Rikonstruksion N.Stacioni 35/10kV Livadnja ne 110/20/10kV , Tr. ONAN/ONAF (1x20/25)MVA	Sarande	Livadnja	35/10 kV	(1x1.8)MVA + (1x8)MVA 35/10 kV		(1x20/25) MVA (110/20/10 kV)	(1x20/25) MVA (110/20/10 kV)	(1x20/25) MVA (110/20/10 kV)	2025-2027
16	Rikonstruksion N.Stacioni 35/10kV Delvine ne 110/20/10kV , Tr. ONAN/ONAF (1x20/25)MVA	Sarande	Delvine	35/10kV	(2x1.8)MVA+(1x5.6)MVA 35/10kV		(1x20/25) MVA (110/20/10 kV)	(1x20/25) MVA (110/20/10 kV)	(1x20/25) MVA (110/20/10 kV)	2025-2027
17	Ndërtim i N/Stacionit të ri Mskollat 35/10kV si dhe furnizimi me linje 35kV	Tropoje	Mskollate				(1x3.15)MVA (35/10kV)	(1x3.15)MVA (35/10kV)	(1x3.15)MVA (35/10kV)	2025-2027
18	Fuqizimi i N.Stacionit 35/20kV Kinostudio (F828 II) transformatorat (2x15)MVA (1x15)MVA	Tirane	Kinostudio	35/20/6	(1x15)MVA(35/20 kV) + (1x10)MVA (35/6kV)		(1x15)MVA (35/20 kV)	1x15 (35/20 kV)	(2x15)MVA(35/20kV) + (1x10)MVA (35/6kV)	2026
19	Ndërtim i N.Stacionit Uzina Dinamo 110/20kV Transformatore ONAN/ONAF 40/30MVA	Tirane	Uzina Dinamo	35/6kV	(1x10)MVA+(1x5.6)MVA 35/6kV		(2x40/30)MVA 110/20kV	(2x40/30)MVA 110/20kV	(2x40/30)MVA 110/20kV	2025-2027
20	Ndërtim i N/Stacionit I Ri TAMARE 35/10 kV	Shkoder	Tamare	35/10			(2x5.6)MVA (35/10 kV)	(2x5.6)MVA (35/10 kV)	(2x5.6)MVA (35/10 kV)	2025-2027
21	Ndërtim i n.st. të ri Shengjin 110/20kV	Shkoder	Shengjin	110/20			2(31.5MVA) 110/20kV	2(31.5MVA) 110/20kV	2(31.5MVA) 110/20kV	2025-2027
II Investime me Kapitalin e huaj										
Kredi KFV										
1	Ndërtim i N/St të ri ne Valias 110/20kV	Tirane	Valias	35/6	(2x15)MVA (35/6)kV	(2x40)MVA (110/20 kV)		(2x40)MVA (110/20 kV)	(2x40)MVA (110/20 kV)	2023-2024

2	Nënstacioni Spitalit	Durrës	Spitale	110/20	(2x20/31.5)MVA (110/20)kV	(1x40/50)MVA (110/20)kV		(1x40/50)MVA (110/20)kV	(1x20/31.5)MVA A (110/20)kV(1x40/50)MVA (110/20)kV	2023-2024
3	Rikonstruksion i N/Stacionit Shkozec	Durrës	shkozecit	110/35/20/6	(1x20/30/10)MVA A (110/35/6) kV + (2x40)MVA (110/20)kV + (1x20/30/10) MVA (110/35/6 kV)+(1x5.0)MVA (110/6)kV	TR.3(1x40)MVA (110/35/20 /6kV) TR.4 (1x40)MVA (110/35/20 /6kV)		TR.1(1x40)MVA (110/35/20 /6kV TR.3 (1x40)MVA (110/35/20 /6kV)	Tr.1(1x40)MVA (110/35/20 /6kV , Tr.3 (1x40)MVA (110/35/20 /6kV) + Tr.2dheTr.4 (2x40)MVA (110/20)kV	2023-2024
Kredi BERZH										
1	Ndërtimi i N/Stacionit Qendër	Tiranë	Qendër	110/20	1x50/80		05/80 (110/20 kV)	2 x 60/80 (110/20 kV)	2 x 60/80 (110/20 kV)	2024-2026

Parashikimi i investimeve është bazuar edhe në studimin “Investment and Network Development Plan for the Electricity Distribution Sector in Albania”, realizuar me financime të Donatorëve të Huaj.

Ashtu sic e kemi diskutuar dhe më parë vlen T’ju theksoj se për vitin 2023 kemi prioritet rajonin e Tiranës dhe në vecanti Nënstacionin e Zogut të Zi .

Duke qene se ky nënstation ka nje rëndësi të vecante për furnizimin e qendrës së Kryeqytetit dhe për të përballuar rritjen e kërkesës për energji si pasojë e zhvillimeve të vullshme urbane do T’ju kërkoja që të merrni masa për furnizimin e këtij Nënstacioni me linje 110 kV.

Jemi të gatshëm dhe te hapur për çfaredo lloj diskutimi dhe koordinimi të nevojshëm.

Duke ju uruar punë të mbarë,

Me konsideratë,

Blendian DALIPI

Administrator

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A.